

ZONA E PUSHTIMIT BULLGAR NË KOSOVË GJATË LUFTËS SË DYTË

BOTËRORE 1941-1945

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I HISTORISË - KOHA E RE

NGA

URESË EMINI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË

PRISHTINË

KORRIK, 2026

REZYME E TEMËS SË DIPLOMËS

Mentori: Prof. Asoc. Dr. Nuri Bexheti

Kandidati-ja: Uresë Emini

Tema: Zona e pushtimit bullgar në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore 1941-1945

Studimi i temës “Zona e pushtimit Bullgar në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore 1941-1945” synon të paraqesë objektivin dhe rëndësinë e studimit të zonave të pushtimit bullgar në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore (1941–1945). Ajo vendos kornizën historike dhe hapësinore të pushtimit, duke e trajtuar Kosovën si një territor të ndarë administrativisht ndërmjet fuqive të Boshtit, ku Bullgaria ushtroi kontroll ushtarak dhe administrativ në zona të caktuara. Ku thekson ndikimin e pushtimit bullgar në zhvillimet politike, shoqërore dhe kulturore, si dhe pasojat e tij mbi popullsinë vendore. Punimi mbështetet kryesisht në literaturën historike, dokumentet arkivore dhe burimet zyrtare që trajtojnë pushtimin bullgar në Kosovë gjatë viteve 1941–1945. Këto burime paraqesin një bazë të rëndësishme për studimin e organizimit administrativ, zhvillimeve politike, gjendjes ekonomike e shoqërore, si dhe pozitës së popullsisë shqiptare në zonën e pushtimit bullgar.”

Gjatë formulimit të punimit kemi përdorur metoda analitike dhe krahasuese, të cilat kanë mundësuar shqyrtimin dhe krahasimin e të dhënave të pushtimit bullgar në Kosovë, literatura përkatëse dhe analiza të burimeve arkivore, dokumenteve zyrtare. Punimi është i strukturuar në katër kapituj, në të cilët shtjellohen aspektet kryesore të pushtimit bullgar në Kosovë.

Në kapitullin e parë trajtohet konteksti i përgjithshëm historik dhe politik që çoi në pushtimin e Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore, me theks të veçantë në rrethanat që mundësuan vendosjen e administratës bullgare në zona të caktuara të territorit kosovar. Fillimisht, shqyrtohen zhvillimet politike dhe ushtarake në Ballkan në prag të luftës, si dhe pozita e Mbretërisë së Jugosllavisë përballë presionit të fuqive të Boshtit. Në këtë kuadër analizohet kapitullimi i Jugosllavisë në prill të vitit 1941 dhe ndarja territoriale e Kosovës ndërmjet pushtuesve, si rezultat i interesave strategjike dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të kohës. Kapitulli ndalet në motivet politike dhe ushtarake të Bullgarisë për zgjerim territorial, duke e vendosur pushtimin e zonave të Kosovës në kuadrin e aspiratave shtetërore bullgare dhe rolit të saj si aleate e Boshtit. Gjithashtu,

trajtohen rrethanat konkrete të vendosjes së pushtimit bullgar, përfshirë hyrjen e forcave ushtarake, përcaktimin e kufijve administrativë dhe reagimet fillestare të popullsisë vendore. Nëpërmjet këtij kapitulli synohet të ndërtohet baza historike dhe analitike e domosdoshme për të kuptuar zhvillimet e mëvonshme politike, shoqërore dhe administrative që do të trajtohen në kapitujt vijues të punimit.

Në kapitullin e dytë shqyrtohet zona e pushtimit bullgar dhe pozita e shqiptarëve gjatë viteve 1941–1944. Në këtë kapitull analizohet gjendja e popullsisë shqiptare nën administrimin bullgar gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore, përcaktimi i vijës kufitare të zonës së pushtimit bullgar, si dhe vendosja e administratës bullgare dhe ndikimi i saj në jetën e shqiptarëve. Gjithashtu, shqyrtohet gjendja ekonomike në territoret e pushtuara, vështirësitë me të cilat u përball popullsia vendase dhe zhvillimi i arsimit përmes funksionimit të shkollave shqipe në zonën e pushtimit bullgar. Në tërësi, kapitulli paraqet aspektet politike, administrative, ekonomike dhe arsimore të jetës së shqiptarëve nën pushtimin bullgar gjatë viteve 1941–1944.

Në kapitullin e tretë trajton represionin e ushtruar nga administrata bullgare ndaj shqiptarëve dhe format e rezistencës së tyre gjatë viteve 1941–1944. Në këtë kapitull analizohen dhuna ndaj popullsisë civile shqiptare, burgosjet masive, arrestimet dhe internimet që u përdorën si mjete shtypjeje ndaj shqiptarëve. Gjithashtu, shqyrtohen format e hershme të kundërshtimit ndaj pushtimit bullgar, duke përfshirë veprimtaritë e organizuara kundër administratës pushtuese. Një vëmendje e veçantë i kushtohet organizimit të lëvizjeve çlirimtare dhe përpjekjeve të shqiptarëve për të mbrojtur të drejtat e tyre dhe për t'i rezistuar pushtimit. Në tërësi, kapitulli paraqet pasojat e represionit bullgar dhe zhvillimin e rezistencës shqiptare në këtë periudhë historike.

Në kapitullin e katërt trajton operacionet ushtarake bullgare dhe procesin e tërheqjes së Bullgarisë nga Kosova gjatë vitit 1944. Në këtë kapitull analizohen operacionet ushtarake të zhvilluara nga forcat bullgare në Kosovë gjatë muajve tetor–nëntor 1944, si dhe tensionet politike dhe ushtarake ndërmjet forcave jugosllave dhe bullgare. Gjithashtu, shqyrtohet procesi i tërheqjes së trupave bullgare nga territori i Kosovës, incidentet që shoqëruan këtë tërheqje dhe pasojat e tyre për popullsinë vendase. Në fund, kapitulli paraqet kapitullimin e Bullgarisë dhe kolapsin e administratës bullgare, duke shënuar përfundimin e pushtimit bullgar në Kosovë dhe ndryshimet politike e ushtarake që pasuan.

Në fund të punimit paraqiten përfundimet kryesore të hulumtimit, në të cilat evidentohen veçoritë e pushtimit bullgar në Kosovë gjatë viteve 1941–1945, organizimi administrativ i zonës së pushtimit, gjendja ekonomike dhe arsimore e popullsisë shqiptare, si dhe format e represionit dhe

rezistencës shqiptare ndaj administratës bullgare. Gjithashtu, analizohen operacionet ushtarake bullgare dhe procesi i tërheqjes së Bullgarisë nga Kosova në fund të Luftës së Dytë Botërore.

PYETJET KËRKIMORE

- Cilat ishin rrethanat historike dhe politike që çuan në vendosjen e pushtimit bullgar në zona të caktuara të Kosovës gjatë viteve 1941–1945?
- Si u përcaktua shtrirja territoriale e zonës së pushtimit bullgar në Kosovë dhe cilët faktorë ndikuan në këtë ndarje administrative?
- Çfarë strukturash administrative dhe mekanizmash kontrolli vendosi pushteti bullgar në zonat e pushtuara të Kosovës?
- Cilat ishin politikat represive të zbatuara ndaj popullsisë shqiptare dhe si ndikuan ato në jetën e përditshme shoqërore, ekonomike dhe kulturore

HIPOTEZAT

- Pushtimi bullgar i zonave të caktuara të Kosovës gjatë viteve 1941–1945 nuk ishte vetëm rezultat i rrethanave ushtarake të Luftës së Dytë Botërore, por edhe shprehje e aspiratave politike dhe territoriale afatgjata të Bullgarisë në rajon.
- Shtrirja territoriale e zonës bullgare në Kosovë u përcaktua mbi baza strategjike dhe administrative, duke reflektuar interesat ushtarake dhe politike të pushtetit pushtues, më shumë sesa realitetin etnik dhe shoqëror të popullsisë vendore.
- Administrata bullgare zbatoi politika represive sistematike ndaj popullsisë shqiptare, të cilat ndikuan ndjeshëm në jetën shoqërore, ekonomike dhe kulturore në zonat e pushtuara.
- Pavarësisht kontrollit të fortë administrativ dhe represionit, popullsia shqiptare shfaqti forma të ndryshme të rezistencës, të organizuara dhe spontane, kundër pushtimit bullgar.
- Përfundimi i pushtimit bullgar në Kosovë u ndikua drejtpërdrejt nga zhvillimet ushtarake dhe politike të fundit të Luftës së Dytë Botërore, duke lënë pasojë të rëndësishme në strukturën politike dhe shoqërore të Kosovës në periudhën e pasluftës.